



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 11.09.2026

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 10, datë 15.1.2026, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2026, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendin e pa plotësuar si më poshtë vijon:

➤ **DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

SEKTORI I PROTOKOLLIT DHE ARKIVËS

SPECIALIST me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b.

➤ **Detyrat kryesore:**

- Pranon, evidenton dhe shpërndan korrespondencën zyrtare që vjen në AZHBR si dhe kryen veprimet për nisjen e korrespondencës zyrtare në destinacionin përkatës.
- Shpërndan dokumentet në drejtoritë apo sektorët e Agjencisë sipas përcaktimit të titullarit.
- Hap dosje sipas pasqyrës emërtuese, sistemon dhe përditëson ato gjatë gjithë vitit.
- Sistemon dokumentet sipas natyrës dhe përmbajtjen së tyre në dosjen përkatëse.
- Mban, ruan dhe administron vulën e institucionit në rastet kur kjo detyrë i delegohet nga përgjegjësi i sektorit.

➤ **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kriterë:**

- Diplomë e nivelit “Bachelor” në Shkenca Shoqërore. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
- Preferohet të kenë përvojë pune ose intership/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”;
- Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 16.9.2026, ora 16:30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollësja”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po

aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për pozicionet e mësipërme, do të marrin informacion vetëm në faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
Ardita Kuçi